**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**Komuna e Drenasit**
**Kuvendi i Komunës**

02 **Nr.** 060/01-17218 **dt.** 20. 04. **2022**

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Gllogocit), nenit 3 pika 3.7 si dhe nenit 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **27.04.2022**, (E Mërkurë) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

1. Procesverbali i mbledhjes të Kuvendit Komunal të dt. 24.03.2022
2. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit 12 nr. 462/01-47368 të datës 30.10.2020, të Kuvendit të Komunës së Drenasit.
3. Propozim-vendim për shpronësimin e njësive të ndërtesave–banesave, në parcelën nr. 743-30, në zonën kadastrale në Gllogoc.
4. Propozim-vendim për këmbimin e pjesëve të njësive kadastrale nr.538/0 dhe 512/0 në zonën kadastrale në Nekoc.
5. Propozim-vendim për caktimin e lokacionit për zbatimin e Aktgjykimit C nr. 97/86, të dt. 06.10.1988.
6. Propozim-vendim për bartjen e të hyrave vetanake.
7. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 02-020/04-8424, të dt. 23.02.2022.
8. Propozim-vendim për revidimin e Planit Komunal të menaxhimit të mbeturinave për vitin 2022, i plotësuar.
9. Raporti Financiar Janar-Mars 2022.
10. Propozim për ndryshimin dhe plotësimin të Rregullores për ndarjen e subvencioneve.
11. Njoftim për plotësimin me anëtar të KKSB-së (Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi) dhe përfaqësuesin e Komitetit për Komunitete, plotësim të vendimit me nr. 12.030-65514 të dt. 23.12.2021, dhe vendimit me nr. 12.030/01-65508 të dt. 23.12.2021.
12. Të ndryshme.

Drenas, 20.04.2022

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Milaim Hajdari

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Zyra e Kuvendit

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY

| Pranuar | 20.04.2022 | | |
|---|---|---|---|
| Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera |
| 02- | 052/09 | -17216 | |

**Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 20.04.2022, si vijon:**

Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e K. P. F-ca, për rendin e ditës, dhe i njoftoi lidhur me pikën shtese: Njoftim për plotësimin me anëtar të KKSB-së (Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi) dhe përfaqësuesin e Komitetit për Komunitete, plotësim të vendimit me nr. 12.030-65514 të dt. 23.12.2021, dhe vendimit me nr. 12.030/01-65508 të dt. 23.12.2021.

Pasi qe nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime tjera për rendin e ditës kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës dhe votuan me: 06 vota **(për),** 00 kundër, 00 abstenim.

1. Procesverbali i mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur me dt. 17.03.2022.
   **Nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, dhe kaloj me vota unanime.**

2. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit 12 nr. 462/01-47368 të datës 30.10.2020, të Kuvendit të Komunës së Drenasit.
   Pas diskutimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditë, votuan me**: 1 votë (Për), 1 (një) tërheqje nga votimi për arsyeje të konfliktit të interesit, 2 (Abstenim), 3 (Kundër)**

3. Propozim-vendim për shpronësimin e njësive të ndërtesave–banesave, në parcelën nr. 743-30, në zonën kadastrale në Gllogoc.
   Pas diskutimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditë, votuan me**: 1 votë (Për), 1 (një) tërheqje nga votimi për arsyeje të konfliktit të interesit, 2 (Abstenim), 3 (Kundër).**

4. Propozim-vendim për këmbimin e pjesëve të njësive kadastrale nr.538/0 dhe 512/0 në zonën kadastrale në Nekoc.
   **Nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, dhe kaloj me vota unanime, dhe e rekomanduan këtë pikë të rendit të ditës për kuvend.**

5. Propozim-vendim për caktimin e lokacionit për zbatimin e Aktgjykimit C nr. 97/86, të dt. 06.10.1988.
   Me vërejtje kërkohen plotësim te dokumentacionit për këtë propozim vendim.

6. Propozim-vendim për bartjen e të hyrave vetanake.
   **Nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, dhe kaloj me vota unanime, dhe e rekomanduan këtë pikë të rendit të ditës për kuvend.**

7. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 02-020/04-8424, të dt. 23.02.2022.
   **Nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, dhe kaloj me vota unanime, dhe e rekomanduan këtë pikë të rendit të ditës për kuvend.**

8. Propozim-vendim për revidimin e Planit Komunal të menaxhimit të mbeturinave për vitin 2022, i plotësuar.
   **Nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, dhe kaloj me vota unanime, dhe e rekomanduan këtë pikë të rendit të ditës për kuvend.**

9. Raporti Financiar Janar-Mars 2022.
   **Nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, dhe kaloj me vota unanime, dhe e rekomanduan këtë pikë të rendit të ditës për kuvend.**

10. Propozim për ndryshimin dhe plotësimin të Rregullores për ndarjen e subvencioneve.
    **Nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, dhe kaloj me vota unanime, dhe e rekomanduan këtë pikë të rendit të ditës për kuvend.**

11. Të ndryshme.
    Pati diskutime, pyetje dhe kërkesa në interes të përgjithshëm të qytetareve.

**Pasi nuk pati diskutime mbledhja përfundoi në ora 11: 45**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Milaim Hajdari**

Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës

02 Nr.060/04-17227dt. 20.04.2022

**PROCESVERBALI**

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **24.03.2022**

**Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari**

**Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 29 anëtarë.**

Kuvendi filloi punimet më këtë :

**Rend dite:**

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i KK i mbajtur me dt. 23.02.2022, dhe Procesverbali i mbledhjes së Jashtëzakonshme i KK i mbajtur me dt. 08.03.2022.
2. Raporti i punës Janar-Dhjetor 2021 i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale.
3. Raporti i dytë periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2020.
4. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në kategorinë për mallrat dhe shërbimet në buxhetin e drejtoratit për shërbimet publike dhe emergjente për projektet: mirëmbajtja e kanalizimeve fekale, atmosferike dhe gropave septike dhe rehabilitimi i rrugëve të asfaltuara.
5. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në kategorinë për Mallra dhe shërbime në buxhetin e drejtoris për inftastruktur publike.
6. Të ndryshme.



Mbahet mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës
Të enjten, në Sallën e Kuvendit, është mbajtur mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës, ku për diskutim ishin 6 pika për rend dite.
Fillimisht, në shenjë respekti e mirënjohje për veprimtarinë ndaj Kosovës të ish-Sekretares së Shtetit të SHBA-së, Madeleine Albright, është mbajtur një minutë nderim.

Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Milaim Hajdari, ndërsa merrnin pjesë, kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Arben Shala, drejtor të drejtorive komunale dhe anëtarë të Kuvendit, si dhe 29 anëtar të kuvendit Komunal.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hadari**- pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit njoftoi me rendin e ditës anëtaret e Kuvendit Komunal, pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar dhe votuan me: **29 (Për)**, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Më poshtë ju elaborojmë pikat që janë diskutuar e miratuar në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës;

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: 1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i KK i mbajtur me dt. 23.02.2022, dhe Procesverbali i mbledhjes së Jashtëzakonshme i KK i mbajtur me dt. 08.03.2022.

Pasi nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime, procesverbali i mbledhjes së rregullt i KK i mbajtur me dt. 23.02.2022 dhe procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme i KK i mbajtur me dt. 08.03.2022, ka kaluar me vota unanime.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Raporti i punës Janar-Dhjetor 2021 i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale.**
**Drin Halilaj,** tek raporti i punës të kryetarit të Drejtoria për Arsim në raportin e punës në përfundim, për vitin 2021 përmend formimin e një komisioni i cili ka për detyre të skanoj gjendjen në teren dhe të nxjerr rekomandime në funksion të përmirësimit të cilësisë, a mund të informohemi në pika të shkurtra rreth këtij komisioni dhe gjendjen në rast se ka përfunduar skanimi. Pyeti për Drejtorinë e Shërbimeve Publike që u cek që është bërë mirëmbajtja e rrugëve gjate dimrit, pastrimi i rrugëve, trotuareve, parkingut, qytetaret rregullisht na kanë dërguar shqetësimet e tyre lidhur me mos pastrimin e rrugëve trotuareve nga bora. Kërkoj që për vitin 2022/2023 të merren masa me kohë në mënyre që mos te rrezikohet jeta e qytetareve tanë.

**Florentina Elezi-Veliu,** pyeti për drejtorinë e inspeksionit, përkatësisht inspeksioni i ndërtimtarisë, tere vitit janë lëshuar 38 urdhra për ekzekutim të aktvendimeve përkatësisht rrenim të objekteve por që nuk janë ekzekutuar ende për arsyeje të ndryshme nga organet kompetente, pse nuk është bërë rrënimi a kanë ndryshuar urdhrat apo është bërë për arsyeje të neglizhencës, gjithashtu sipas përshkrimit nga drejtoria e inspeksionit gjatë vitit 2022 në bashkëpunim me policinë e Kosovës njësiti Drenas do të ketë inspektim me të shtuar për largimin e transportit ilegal të udhëtareve, cila është alternativa e komunës për udhëtaret meqë linja Drenas-Prishtinë janë çdo 30 min në shumicën e orareve e në disa raste edhe çdo 15 min, më shqetësuese është situata e transportit Drenas-Skenderaj ku autobusi qarkullon qdo 1 ore, po ashtu cili është plani i komunës lidhur me transportuesit ilegal. Për Drejtorinë e Shëndetësisë, numri i lindjeve në maternitet është në rënie e sipër, krahas rënies te natalitetit në Republikës të Kosovës vitet e fundit, planifikimi i familjes, migrimi i popullatës në qendra te tjera si dhe lindjet në kliniken obstetrike-gjinekologjike e spitaleve tjera private ka bërë që numri i lindjeve të zvogëlohet. Sa është kapaciteti i lindjeve që mund te realizohet në QKMF në Drenas pasi që në bazë të informatave që kemi shumica e grave udhëzohen për në Prishtinë apo qendra tjera me shku me kry lindje. gjithashtu i kemi tri AMF jo funksionale siç janë në Poklek, Gradicë dhe Abri e Eperme, a mund të na tregoni të mos funksionimit dhe a ka gjasa që të jene funksionale gjatë vitit 2022. Gjithashtu tek shërbimet stomatologjike që kryhen vetëm në QKMF në Drenas në plan të punës për vitin 2022 e keni përmend shtrirjen edhe në Komoran, a është bërë ndonjë hap të shërbimit në QMF në Komoran. Tek Drejtoria e Urbanizmit ka qenë një raport shumë i shkurte, e keni cek për realizimin e projektit ne art trafo ka pasur ndikim pozitiv ne komunitet a mund me na tregu si është bërë matja e ndikimit të këtij projekti për arsyeje se keni ardh në përfundim që ka pas vlerësim pozitiv.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** ky është një raport i punës për vitin 2021 punët të cilat janë bërë, nuk jemi duke fol për planin e vitit 2022 se çfarë do të bëhet.

**Florentina Elezi-Veliu,** derisa në raport e keni cek që është bërë një punë ne duam të dimë se si ka ardh deri tek kryerja e asaj pune apo pse nuk është perfundu me na dhënë arsyet.

**Egzona Tërdevci,** i përmendi disa nga të gjeturat nga raporti i punës të kryetarit dhe qeverisjes lokale, zyra për barazi gjinore, në nëntor është bere një vizite në Polici, Qendrën për punë sociale dhe gjykatë themelore dega në Drenas që është aktivitet që është ne rregull për zyrën e barazisë gjinore, është mirë me e paraqit një raport të shkurtër lidhur me informatat që i ka marrë kjo zyre nga këto institucione, po ashtu nga zyra për barazi gjinore do të prisja një informim lidhur me përfitimin e garantëve nga gratë, a ka pas për vitin 2021 buxhetim të përgjegjshëm gjinor, përjashtohen disa aktivitete shumica e aktiviteteve që janë të pasqyruara tek zyra e barazisë gjinore realisht nuk kanë të bëjnë fare me barazinë gjinore,

disa nga këto që në mënyre direkte nuk lidhen me barazinë gjinore janë pjesëmarrja e z.Lladrovci në ekspozitën e organizuar nga HANDIKOS, qëndrimi i z.Lladrovci në çerdhen ''Ardhmeria'' nuk me duket që lidhet me barazinë gjinore kjo. Përurimi i qendrës ''Flutura Academy as kjo nuk ka të bëj direkt me barazi gjinore, po ashtu udhëheqja e konferencës ndërkombëtare te kampit veror as këtu nuk po e gjej lidhjen me barazi gjinore. Të drejtoria e Administratës është paraqit si sukses funksionimi i kioskave në Drenas dhe Komoran, në Drenas nuk funksionojnë kioska do duhej ta bëni këtë përmirësim në raport, po ashtu janë disa çështje te Drejtoria e infrastrukturës lokale, lista e projekteve të realizuara kapitale është paraqitur vetëm si tërësi nuk janë paraqitur vendet e sakta se ku do te behën investimet, në bazë të një momerandumumi bashkëpunimi që e keni pas me shoqatën ''Jetimate Ballkanit'' për ndërtimin 24 shtëpive të njerëzve me nevoje thuhet se këto shtëpi do te kenë përfunduar deri ne fund te vitit 2021 në raport nuk e shikova që është paraqit përfundimi i këtyre shtëpive, a është bërë ndërtimi i tyre apo jo? Po ashtu nga raporti i drejtorisë për infrastrukture thuhet se ka pas mungesë të veturave për daljen në teren për menaxhim të projekteve, takimeve dhe trajnimeve te ndryshme madje edhe shumë here kane humbur këto takime ne mungesë te veturës, sa ka vetura ne dispozicion Drejtoria e Infrastrukturës, cili është numri optimal që i duhen kësaj drejtorie për funksionim të mirëfilltë si dhe a kanë drejtoritë tjera vetura te lira të cilat mund të përdorshin nga stafi i kësaj drejtorie në mënyrë që punët të përfundojnë siç duhet.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** zyra për barazi gjinore është në zyre te kryetarit prandaj raporti i kësaj zyre del ne raport të kryetarit, zyra për barazi gjinore funksionon ne kuadër të zyrës te kryetarit të komunës.

**Egzona Tërdevci,** nuk e ceka që zyra për barazi gjinore nuk është dashtë me u përfshi në këtë plan të përshkrimit të punëve që i keni bërë vitet e kaluar, unë e pata shqetësimin tek ajo që aktivitetet që janë paraqit tek zyra e barazisë gjinore nuk kanë të bëjnë me barazi gjinore.

**Arbër Halilaj,** tek raporti i punës një vjeçare varësisht se cilën drejtori e analizojmë unë shoh profesionalizimin dhe të kundërtën amatorizmin në menaxhim të dikastereve përkatës nga zyrtaret. Raporti i punës në çdo institucion duhet të jetë i bazuar në planin që e keni pas paraprakisht për vitin 2021 me saktë ne objektivat e këtij plani dhe te shpreh përqindjen e realizimit të tyr, pengesat për mos realizim dhe hapat e tjerë për përmirësim, resurset njerezore buxhetin, periudhat kohore për kryerjen e atyre planifikimeve. Ka raporte të përpiluara mirë si ai i shëndetësisë, i financave por shumica e drejtorive te tjera kanë raportuar në stilin e reportazheve gazetaresk. Do ta analizoj planin vjetor edhe raportin dhe do ta përgatiti nje mostër te caktuar se si raportohet.

**Azemine Bujupi-Gjoka,** sa i përket raportit të punës janar-dhjetor 2021 të kryetarit dhe qeverisjes lokale raporti është i shkruar mirë nga të gjitha drejtoritë mirëpo pjesa praktike duhet me u përputh me pjesën teorike, kane mbet edhe shumë projekte tjera të cilat nuk i keni realizuar edhe pse shumë mirë ato i keni shkruar në letër.

Nuk pati diskutime te tjera dhe kaloj tek pika tjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Raporti i dytë periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2020.**
**Drejtori i Financave-Shyqeri Bublaki,** i njoftoj në pika te shkurtera rreth rekomandimeve që janë dhënë nga zyra kombetare e auditimit. Raporti e Auditimit nga Zyra Kombëtare e

Auditimit për vitin 2020 ka dhënë dhjetë rekomandime. Pjesa e dërmuese e atyre rekomandimeve janë zbatuar në tërësi, kemi rekomandime të cilat jnë realizuar pjesërisht dhe nje rekomandim nuk është zbatuar në tërësi. Rekomandimi i cili nuk është zbatuar në tërësi është rekomandimi që i përket rartimit të projekteve detale për investime kapitale i cili nuk është zbatuar për shkak të operatorit ekonomik i cili e ka marrë tenderin për hartimin e këtyre projekteve dhe e ka realizuar andaj ne si kuvend komunal kemi qenë të obliguar që t'ia ndërpresim kontaten operatorit ekonomik dhe kjo ka ndikuar që ky rekomandim mos të zbatohet në tërësi.

**Arbër Halilaj,** sa i përket raportit vjetor të auditimit të pasqyrave financiare kjo shtjellon një pjesë shumë të rëndësishme të punës të komunës tonë dhe shpalos çështje që kanë të bëjnë direkt me përformancen dhe efikasitetin e komunës në çdo sferë, dihet që tek menaxhimi i përformances fillojmë nga planifikimi i përformances, pastaj vjen faza e monitorimit të matshëm të përformances, vlerësimi i saj, raportimi lidhur me të dhe auditimi i përformances, raportet dhe gjetjet e këtij auditimi për vitin 2020 i keni para jush. Raportet e zyrës kombëtare te auditimit promovojnë drejtpërdrejt llogaridhënien, transparencën që në komunën tone theksohet shpesh dhe besoj që është prezentë dhe konsideroj te domosdoshme për secilën komunë jo vetëm ne komunën tonë pasi që përmes këtyre raporteve mund t'i kërkojmë llogari qdo organizate buxhetore, kjo pastaj ndikon në rritjen e besimit të qytetareve në shpenzimin e duhur dhe korrekt të buxheti, kjo rrjedhimisht e rrit besimin në qeverisjen lokal, nisur nga kjo auditimi është element shumë i rëndësishëm në procesin e vlerësimit te përformances, kurse të gjeturave dhe rekomandimeve nga auditimeve duhet t'ju jepet prioritet i lartë nga fakti se vijnë nga një trup profesionale e kontrollit të jashtëm të përformances të komunës e cila natyrisht është e pavarur në profesionalizimin e saj ndërsa qëllimi i terë ketij procesi është përmirësimi i përfomances dhe përmbushja e pritshemrive të qytetareve. Rezultatet e auditimit e pasqyrave financiare për vitin fiskal 2020-2021 në kuvendin komunal të Drenasit tregojnë se zyra kombëtare e auditimit ka dhënë dhjetë të gjetura apo rekomandime adekuate, kryetari i komunës dhe ekzekutivi duhet të shpenzojnë me përgjegjshmëri dhe në dobi të qytetareve fondet publike në mënyrë efikase duke pas parasysh se kemi pas të bëjmë me një vit pandemik dhe përqindja e realizimit është shumë e mirë, natyrisht shpenzohen ne pajtim me ligjin dhe udhëzimet në fuqi, duke pas parasysh që nevojat e qytetareve janë të larta dhe buxheti i komunës mund të mos të jete i mjaftueshëm prandaj kryetari i komunës mbahet përgjegjës për mënyrën se si i ka shpenzuar fondet publike dhe kjo është arsyeja kryesore që të kryhen auditimet vjetore financiare dhe pajtueshmërisë për të gjitha komunat. Një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve të auditimit nuk po zbatohen dhe disa prej tyre po përsëriten apo po shfaqen prej vitit në vit apo dalin rekomandime të reja që kjo duhet të analizohet pse ndodh. Për tu përmbushur obligimet ligjore komuna duhet të përmirësoj praktiken e shtimit te kontrollit te brendshëm po ashtu duhet të behet me shumë për zhvilluar një mjedis të kontrollit të bazuar në risk me efektivitet më te lartë duke e rritur kështu besueshmërinë në punën e ekzekutivit, planifikimit dhe realizimit të buxhetit. Edhe pse ka qenë pandemia dhe punët kane vijuar me ato vështirësitë që vetëm dihen, nuk mundet gjithçka të arsyetohet bazuar në këtë forcë madhore, rekomandimet e zyrës kombëtare të auditimit duhet të jenë udhë rrëfyes për përmirësime sidomos të kenë prioritetin nga ana e kryetarit i cili çdo vend ceket si përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve për forcimin e kontrollit të brendshëm, koordinimin më të mirë të drejtorive, shpenzimin me efikasitet të buxhetit, planifikimin adekuat, zbatimin e udhëzimit dhe rregullores t punës dhe veprimet tjera menaxheriale të cekura të pjesa e rekomandimeve. Me ketë drejtim ne si asamble dhe veçanërisht si opozitë kërkojmë që të formohen edhe komisione tjera ku do ta ndihmonim punën e kryetarit dhe ekzekutivit meqë kundër dallimeve politike qëllimet i kemi të përbashkëta në të mirë të qytetareve të Drenasit.

**Egzona Tërdevci,** pyeti, në raport me të gjeturat e zyrës kombëtare të auditimit është theksuar si një e gjetur mos kompletimi i njësisë se auditimit të brendshëm a është plotësuar kjo për vitin 2021dhe a ka gjasa te plotësohet për vitin 2022 nëse nuk është bërë deri tani.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** njësia e auditorit të brendshëm në komunën tonë i ka dy zyrtar dhe janë të mjaftueshëm, rekomandimet e auditorit te jashtëm jo gjithmonë janë rekomandime që ne mund t'i zbatojmë.

**Azemine Bujupi-Gjoka,** gjatë auditimit nga zyra kombëtare e auditimit për vitin 2020 janë identifikuar keq menaxhimi në disa fusha si psh. Në fushën e menaxhimit të prokurimit në sektorin e pagesave dhe në menaxhimin e pasurisë, për hir të korrektësisë ndaj qytetareve do t' përmend në keq menaxhim te dhjetë çështjeve të caktuara, çështja A1. Vonesa në deponimin e parasë se gatshme në llogari bankare i keni tri raste: në zyrat e gjendjes civile, administratë dhe participim në QKMF të cilat janë vonuar pagesat për në bankë, çështja A2. Dobësinë në procesin në veprimtarive inspektuese të objekteve brenda territorit të komunës, dmth nuk e keni realizuar atë përqindje sa u dashtë me u be inspektimi, se paku 20 % ju keni arritur vetëm 12%. Çështja A3. Dobësinë e përmbushjen e kriterit të dosjes të tenderit lidhur më vërtetimin tatimor, dmth janë dhënë tenderë pa e pas vërtetimin në pronë ose me skadim të saj. Çështja A4. Mungesa e projektit ekzistues edhe këtu i kemi identifikuar 24 kontrata pune, komuna nuk e ka hartuar projektin ekzistues, por janë zhvilluar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm përmasën dhe parallogaritë. çështja B2. Ndryshimet në pozicionet e kontratave pa aprovimin paraprak të ZKA-së edhe këtu janë bërë disa devijime. Çështja B3. Mangësitë e regjistrit kontabël të pasurisë në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare këtu i keni disa raste të cilat nuk i keni evidenu. Çështja B4 dobësimi i menaxhimit të llogarive te arketueshme, pjesa me e madhe i takon tatimit ne prone. Çështja B5 mangësitë ne lisën e detyrimeve kontingjente i kemi evidentua tri raste, mos kompletimi iniab ku i mungon edhe një auditor ku kish me qenë i nevojshëm për menaxhimin më të mirë në të gjitha këto fusha.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** 80 % e atyre qe i lexove pjesën tjetër te kolonës e kane pas rekomandimin, pra 80% të atyre pra janë te zbatueshme, të pazbatueshme dhe pjesërisht te zbatuara. Nëse flasim ku përmendet paret e imta, bëhet fjale për mos sjelljen e mjeteve në kohen në të cilën kërkohet me ligj. Për mjetet qe i përmende ai zyrtari që ka pas me i dorezu u sëmur dhe nuk kam mujt me i dorëzua e ka arsyetimin, raportin gjitha. Rekomandimet jemi të obliguara që me i zbatua.

**Meqe nuk pati distkutime kaloj tek pika tjetër.**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në kategorinë për mallrat dhe shërbimet në buxhetin e drejtoratit për shërbimet publike dhe emergjente për projektet: mirëmbajtja e kanalizimeve fekale, atmosferike dhe gropave septike dhe rehabilitimi i rrugëve të asfaltuara.**
Meqë nuk pati diskutime vërejte apo sugjerime kryesuesi e hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar dhe votuan me:
29 vota **(Për)**, 00 vota (Kundër), 00 vota (Abstenim)

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike**

**rezerva në kategorinë për Mallra dhe shërbime në buxhetin e drejtorisë për infrastrukturë publike.**

Meqë nuk pati diskutime vërejte apo sugjerime kryesuesi e hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar dhe votuan me:
27 vota **(Për),** 00 vota (Kundër), 02 vota (Abstenim).

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari,** hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Të ndryshme.**

**Egzona Tërdeci,** nisur nga supozimi se njësia e auditimit të brendshëm është në shërbim të interesit të komunës dhe gjithë qytetareve të saj, unë do të bëjë një kërkesë për auditim për kontratat e përfituara nga kompania Fer-Petrol për pesë vitet e fundit, në bazë të planit të punës të auditorit të brendshëm është paraparë auditimi i prokurimeve, nisur nga kjo dhe fakti që kompania e përmendur tani më po dyshohet për mashtrim ndaj institucioneve shtetërore, pa dashur me u perzi në sistemin e drejtësisë vetëm me qëllimin për tu vërtetuar që paraja publike është shpenzuar siq duhet, ne kërkojmë nga zyra e autidimit të brendshëm të bëjë auditimin për kontratat e përfituara nga Fer- Petrol në pesë vitet e fundit dhe për te njëjtat të paraqet raportin e auditimit duke qenë se kompania në fjalë për pesë vitet e fundit ka përfituar me shume se 2 milion euro kontrata nga Komuna e Drenasit konsideroj se kjo kërkesë për auditimin e këtyre kontratave në kompani është në interes të qytetareve dhe është shumë e rëndësishme.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** kush do që ka bërë shkelje janë nën hetime, shkeljen e ligjit e përcakton vetëm gjykata. Kompania Fer- Petroll edhe si shumë kompani tjera që kane marrë kontrata sipas ligjit në Komunën e Drenasit kanë auditim të për vjetshëm, ka shumë kompani që deri më tani nuk kanë pas auditim dhe kanë marrë kontrata dhe ne nuk e kemi zbatuar në përpikëri atë që na lejon ligji, tani e tutje nuk ka me mujt me konkuru asnjë kompani që nuk ka auditim tri vitet e fundit për me e marrë në punë.

**Egzona Tërdeci,** pyeti për drejtorinë e inspeksionit, në bazë të postimeve që i keni bërë në faqen zyrtare të komunës në facebook drejtoria e inspeksionit ka kryer kanë kryer vazhdimisht inspektim të çmimeve neper ndërmarrjet në Komunën e Drenasit, në postimin e dt. 15.03.2022 thuhet se janë shqiptuar masa disiplinore dhe ndëshkuese ndaj operatoreve që kane abuzuar me çmime duke e ditur elementin e njohjes se privatësisë a mund ta dimë të paktën natyrën e bizneseve te cilat kane keq menaxhuar me çmime në Komunën e Drenasit.

**Drejtori i Inspeksionit Petrit Gashi,** Komuna e Drenasit ka qenë prej komunave të para që abuzuar keqpërdorimin në rritjen e çmimeve, ka raportuar në ministri krye inspektorja, dhe Viva Fresh Store ka qenë nder te parat që kemi raportuar dhe masat që komuna jonë i ka marrë ndaj saj, inspeksioni ka qenë vazhdimisht ne teren për kontrollimin e tregut përgjithësisht në Komunën e Drenasit jo vetëm të maketeve por edhe të pikave te ndryshme të karburantit sipas rekomandimeve që na vijnë edhe nga niveli qendror.

**Mehedin Salihu,** kërkoj që të behën rrethojat e shkollës, dhe trotuaret ka shkojnë nxënësit ne shkolle janë krejtësisht të dëmtuara, po ashtu një parking të KEKU ku është një pjesë shumë e rrezikshme për kalimtarë, edhe ura është e dëmtuar, edhe një gropë është para se me shku tek shkolla e mesme në Drenas. Kisha kërkuar që rrugët që duhet me u mirëmbajt sidomos në fshatra rurale mos te lihen anash e kam fjalën për fshatin Shtuticë ku ka dëmtime në rrugë

dhe asnjëherë nuk është marre ndonjë masë për riparim por edhe me vende tjera. Te Drejtoria e Shendetesisë në QMF në Drenas mungon lifti, kërkoj që të bëhet një zgjidhje.
**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci,** rruga Komoran-Drenas-Polluzhë është rrugë regjionale dhe është përgjegjese Ministria e Infrastruktures. Ne kemi bërë kerkesa për riparim te rruges.

**Mehedin Salihu**, i vetmi fshat qe është lëne pas dore është fshati Shtutice, dhe i vetmi fshat që nuk ka as ambulad është fshati Shtuticë. Disa fshatra janë lënë pas dore në infrastrukture.

**Valentina Leku,** dua te lidhem të transferi te mjeteve i cili kalon për shërbime publike, mirëmbajtja e kanalizimeve i cili është në një gjendje aspak të mire, në fshatin Llapushnik rruga - magjistralja "Ibrahim Rugova" prej vëllezërve Thaqi e deri të mbi kalimi banoret po ankohen se ujerat e zeza po kalojnë edhe ne puse apo bunare, pikërisht këtu është edhe trotuari ku shkojnë fëmijët për në shkolle, sidomos tani në kohërat e nxehta ka mundësi qe nxënësit të rrezikohen edhe nga ndonjë epidemi, pastaj kanalizimin cili gjendet në prani te shkollës është akoma edhe me e rrezikshme sepse nxënësit kalojnë aty, dhe dua të bëjë një kërkesë të cilën do ta bëjmë edhe me shkrim, pasi që ne vetëm kemi hy ne stinën e pranverës, edhe shumë qytetarë prej kërkesave më te mëdha dëshirojnë që në qytetin e tyre të kenë një park apo kënd të lojërave që do ta bënte edhe qytetin më të bukur, ashtu siç edhe GREEN për Drenasin në bazë të nevojave të njerëzve parasheh më shumë breza të gjelbër. Po ashtu në qytezën Komoran një vend shumë i frekuentuar është shumë e nevojshme të ketë një hapësirë për kreacion për të gjitha moshat kjo kërkesë është bërë nga vete fëmijët të cilët shprehen ''nuk duam lodra brenda por duam ta prekim lulet-dheun'' Dhe dua të sjellë një çështje këtu në kuvend çështjen e deponisë inerte në fshatin Llapushnik ajo hapësirë bukur e madhe rruga e asfaltuar ku qytetaret mund ta shfrytëzonin për ecje-vrapim por fatkeqësisht kjo është e pamundur, kundërmon aromë shumë e keqe, rreziku nga qentë endacak, pronat private pranë të cilat punohen por njëkohësisht dëmtohen duke u mbuluar me mbeturina, imazhi në këtë vend është mjerim, në këtë vend është krim në natyre, është vatër e infeksioneve lusim komunën e tonë qe te reagojnë dhe intervenojnë menjëherë.

